


## 1. PAMJE E SHKURTËR

Viti 2002 u karakterizua nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm i shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave e shpenzimeve korente, duke regjistruar një deficit prej 407 milionë dollarësh, shifër kjo më e larta përgjatë dhjetë viteve të fundit dhe përfaqëson 8.6 për qind të PBB kundrejt 5.2 për qind në vitin 2001. Ky përkeqësim ka ardhur nga thellimi i deficitit korent si dhe nga ngadalësimi i rritjes ekonomike 4.7 për qind nga 6 për qind e parashikuar.

Grafik 1. Llogaria korente në PBB.



Ky deficit është financuar me rreth 78 për qind prej flukseve neto të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 328 milionë dollarë. Pjesa e mbetur e deficitit korent është financuar nga transaksione të tjera

të paidentifikuara, të cilat reflektohen në zërin Gabime dhe Harresa<sup>1</sup>. Rezervat e autoritetit monetar janë rritur me 28.6 milion dollarë.

**Tabelë 1. Bilanci shqiptar i pagesave gjatë viteve (në mln usd).**

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
<b>Llogaria Korente</b>	<b>31.4</b>	<b>36.6</b>	<b>-62.3</b>	<b>-253.7</b>	<b>-65.0</b>	<b>-132.9</b>	<b>-163.1</b>	<b>-217.9</b>	<b>-406.8</b>
Eksporti i mallrave fob	141.4	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.4	304.6	330.2
Importi i mallrave fob	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,076.4	-1,331.6	-1,485.4
Bilanci tregtar	-459.6	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-821.0	-1,027.0	-1,155.1
Shërbimet: Kredi	83.1	98.2	127.3	67.9	86.6	266.7	448.1	533.5	585.0
Shërbimet: Debi	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-129.3	-165.4	-430.0	-444.2	-589.5
Të ardhurat: Kredi	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	162.5	148.3
Të ardhurat: Debi	-41.4	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-13.4	-20.6
Transferrat private	374.1	348.9	476.0	235.7	421.3	188.4	438.6	542.6	586.9
Transferrat shtetërore	117.1	128.5	83.4	29.0	82.6	165.0	94.4	28.1	38.2
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>21.6</b>	<b>389.5</b>	<b>4.9</b>	<b>2.1</b>	<b>31.1</b>	<b>67.5</b>	<b>78.2</b>	<b>117.8</b>	<b>121.2</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>24.2</b>	<b>-414.5</b>	<b>49.6</b>	<b>140.7</b>	<b>16.0</b>	<b>36.8</b>	<b>182.5</b>	<b>109.0</b>	<b>206.2</b>
Investime direkte	53.0	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	207.3	135.0
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	-23.4	-36.8
Kapitale të tjera	-28.7	-484.5	-40.5	93.2	-29.0	-4.4	64.5	-86.9	102.7
Gabime dhe harresa	-44.5	7.9	54.8	142.5	69.4	131.3	15.0	136.1	108.0
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>54.9</b>	<b>30.6</b>	<b>47.0</b>	<b>43.8</b>	<b>59.4</b>	<b>123.5</b>	<b>131.9</b>	<b>145.0</b>	<b>28.6</b>
Rezerva & zëra të lidhur me të									
Mjetet e rezervës	-54.9	-30.6	-47.0	-43.8	-59.9	-123.6	-131.9	-145.0	-28.6
Përdor. kred. & huash nga fondi	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	12.0	5.3
Det. ndaj auto. monet. të huaja	...	...	...	...	...	...	...	...	...
Financime të jashtëzakonshme	...	...	...	...	...	...	...	...	...
<b>Për t'u përmendur</b>									
Ndryshim i Rezervave	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	-116.2	-109.9
Efekt i kursit i këmbimit	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	1.5	65.0

Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë.

Siç ka ndodhur historikisht në zhvillimet e bilancit të pagesave, **bilanci tregtar** ka influencuar edhe këtë vit në rritjen e deficitit korent. Deficiti tregtar arriti në rreth 1.2 miliardë dollarë dhe vlerësohet 12 për qind më i lartë krahasuar me vitin 2001. Në raport me PBB deficiti tregtar vlerësohet në nivelin 25 për qind. Përkeqësimi i vazhdueshëm i deficitit tregtar është drejtëpërsëdrejti i lidhur me ecurinë e dobët të eksporteve.

**Tregtia në shërbime** rezultoi me një bilanc negativ prej 5.2 milionë dollarë ndërkohë që viti 2001 rezultoi me suficit (89 milionë dollarë). Ky deficit ka ardhur

<sup>1</sup> Në mungesë të statistikave nga burimet zyrtare, statistikave të bilancit të pagesave në disa shifra përmbajnë vlerësime të Bankës së Shqipërisë, për rrjedhim ajo rezervon të drejtën të revizionojë këto statistika kur të dhënat zyrtare të bëhen të vlefshme.


si pasojë e rritjes së madhe të importit të shërbimeve kryesisht të aktivitetit të turizmit (shpenzimeve jashtë) si dhe rritjes së shërbimeve të transportit të mallrave si rrjedhojë e rritjes së impoorteve tregtare.

Bilanci pozitiv i “**të ardhurave**” në fund të vitit vlerësohet rreth 15 për qind më i ulët se një vit më parë. Kjo rënie i dedikohet të ardhurave nga investimet, kryesisht interesave të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente të cilat vlerësohen 2.4 herë më të ulta se ato të një viti më parë.

Në fund të vitit, bilanci pozitiv i **transfertave korente** u vlerësua rreth 613.2 milionë dollarë. Në shtesë të rritjes së dërgesave nga emigrantët dhe të transfertave hyrëse shtetërore, rritja e suficitit në këtë kategori, i detyrohet edhe rënies së transfertave të tjera dalëse.

Suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare financoi deficitin korent 78 për qind dhe u shoqërua me rritjen prej 28 milionë dollarësh të rezervave të autoritetit monetar.

**Grafik 1. Llogaritë e bilancit të pagesave (në mln usd).**



## 2. LLOGARIA KORENTE

Transaksionet korente vlerësohen rreth 3.9 miliardë dollarë ose 10 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Komponentët kryesorë të llogarisë korente, bilanci tregtar dhe ai i shërbimeve, në vitin 2002 paraqiten me volume të mëdha transaksionesh. Përveç tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime, në këtë rritje kanë kontribuar dhe transfertat korente kryesisht të ardhurat nga emigrantët.

## **2.1 TREGTIA E JASHTME**

Shkëmbimet në mallra, të regjistruara gjatë vitit 2002, ruajtën tendencën në rritje që ka karakterizuar fluksin tregtar të vendit pas krizës ekonomiko-politike të vitit 1997, e cila duke goditur kapacitetin prodhues të vendit frenoi rrjedhën rritëse të eksporteve si dhe të investimeve të huaja në vend.

Volumi i përgjithshëm tregtar llogaritet në 1.8 miliardë dollarë dhe përfaqëson rreth 47 për qind të volumit të shkëmbimeve korente. Kundrejt vitit 2001, tregtia në mallra vlerësohet në rritje, rreth 11 për qind. Në raport me PBB tregtia qëndron në nivelin 40 për qind, duke përbërë një tregues të rëndësishëm për shkallën e hapjes së vendit.


Ashtu si në periudhat e mëparshme, edhe në këtë vit, peshën më të madhe në volumin tregtar e zënë importet (rreth 82 për qind), gjë që flet për një ekonomi dhe treg të brendshëm të orientuar nga importi.

Importi i mallrave regjistroi 1.5 miliardë dollarë, me 12 për qind rritje kundrejt vitit 2001. Ai vlerësohet më i larti në këto dhjetë vitet e fundit. Ndërkohë që, eksporti i mallrave u vlerësua në nivelin 330 milionë dollarë, me rritje 8 për qind ndaj vitit paraardhës. Niveli i ulët i eksporteve nuk i është përgjigjur kërkesës gjithnjë në rritje të importeve duke mbetur faktor kryesor në thellimin e deficitit tregtar. Koeficienti i mbulimit të importit nga eksporti, për vitin 2002, vlerësohet në nivelin 22 për qind.

Deficiti tregtar në vlerë absolute është rritur në mënyrë të vazhdueshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, duke arritur në nivelin më të lartë, 1.2 miliardë dollarë, në vitin 2002. Deficiti tregtar është i pranishëm përgjatë gjithë grupmallrave me

përjashtim të grupit veshje të këmbëve, në të cilin vlera e shtuar në rieksperte bën që ky grupmall të regjistrojë vazhdimisht bilanc pozitiv. Importet e larta në mallra ushqimorë, produkte minerale dhe metale bazë cilësohen si faktorët që shkaktuan, në masën më të madhe, thellimin e deficitit tregtar, krahasuar me një vit më parë.

**Grafik 2. Bilanci tregtar (në mln usd).**



### 2.1.1 Struktura në eksporte dhe importe sipas përpunimit aktiv


Shkëmbimet tregtare nga industria e përpunimit me material të porositësit, që përfaqësojnë pjesën më të madhe të aktivitetit të subjekteve me kapital të huaj, zenë një vend të rëndësishëm në fluksin tregtar të Shqipërisë me botën.

Gjatë vitit 2002, eksportet nga kjo industri përfaqësuan në masën 74 për qind të ardhurat vjetore në eksporte. Importi i mallrave për përpunim të mëtejshëm (prodhim mall i porositur) u vlerësua në 18 për qind të shpenzimeve totale për importe.

TREGTIA	Volumi (në mln usd)			Pesha (%)			Ndryshimi (%) 2002/2001
	2000	2001	2002	2000	2001	2002	
<b>Totali i eksportit</b> <i>nga të cilat:</i>	<b>255.9</b>	<b>304.6</b>	<b>330.2</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>8.4</b>
Eksport i zakonshëm	76.1	81.8	85.2	29.7	26.9	25.8	4.1
Rieksport nga përpunimi aktiv	179.8	222.8	245.1	70.3	73.1	74.2	10.0
<b>Totali i importit</b> <i>nga të cilat:</i>	<b>1,089.4</b>	<b>1,346.2</b>	<b>1,501.7</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>11.6</b>
Import i përkohshëm për përpunim aktiv	165.6	201.0	250.6	15.2	14.9	16.7	24.7
Importe ndihma	23.8	12.7	14.4	2.2	0.9	1.0	13.8

Me fillesa kryesisht në vitin '96, vit ky që shenoi hapjen e shumë subjekteve të industrisë përpunuese në vend, ky aktivitet kulmoi në vitin 2002. Rritja vjetore vlerësohet 10 për qind në eksportet e kësaj kategorie dhe 25 për qind në importe, krahasuar me vitin 2001.

**Grafik 4. Tendencat në ecurinë e tregtisë nga fusha e përpunimit aktiv, (indeks: T1 1996=100).**



Industria e përpunimit me material të porositësit është e përqendruar kryesisht në përpunimin e mallrave tekstilë, veshje këmbësh, lëkurë dhe metale, të cilat së bashku përbëjnë 89 për qind të aktivitetit tregtar të saj, me investitorë kryesorë Italianë dhe Greqinë.

Situata e vështirë energjitike në vend (e cila u rishfaq në dimrin e vitit 2001-2002) mendohet të ketë patur ndikime negative në realizimin e eksporteve të kësaj kategorie në gjysmën e parë të vitit 2002, të cilat u vlerësuan 7 për qind në rënie ndaj gjysmës së parë të viti 2001. Megjithatë, në pjesën e dytë të vitit vihet re një rimëkëmbje e aktivitetit prodhues me material të porositësit, që solli eksporte të larta të kësaj kategorie, duke iu shmangur, gjithashtu, sezonalitetit që i karakterizon këto eksporte (gjatë tremujorit të tretë të vitit, për sezonin e pushimeve, regjistrohet niveli më i ulët në rieksperte). Këto zhvillime, bën që realizimi vjetor i eksporteve nga industria e përpunimit me material të porositësit të vlerësohet në rritje ndaj vitit paraardhës.

Ndërkohë, tendenca e rrjedhave të importeve “lëndë e parë” për këtë industri nuk është ndikuar negativisht nga situata energjitike. Kështu, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2001 importet e kësaj kategorie vlerësohen 22 për qind më të larta krahasuar me periudhën paraardhëse.

### **2.1.2 Importi dhe eksporti sipas grupmallrave**

**Importi tregtar** është shfaqur qëndrueshëm në rritje përgjatë gjithë tremujorëve të vitit.

**Tabelë 3. Importi sipas 21 grupmallrave (në milionë usd).**

HS	PËRSHKRIMI	Volumi (në milionë dollarë)			Pesha (në %)			Ndryshimi (në %) 2002/2001
		2000	2001	2002	2000	2001	2002	
I	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	29.3	28.6	45.2	2.8	2.2	3.0	57.9
II	Produktet vegjetale	86.7	100.3	101.3	8.1	7.6	6.8	1.0
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	18.1	19.8	20.8	1.7	1.5	1.4	5.1
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	97.0	107.1	130.5	9.1	8.1	8.8	21.8
V	Produkte minerale	143.5	184.6	192.3	13.5	13.9	12.9	4.2
VI	Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	58.9	71.5	86.1	5.5	5.4	5.8	20.3
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	31.8	37.3	44.7	3.0	2.8	3.0	19.9
VIII	Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	19.1	27.6	36.8	1.8	2.1	2.5	33.5
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	10.4	12.1	16.3	1.0	0.9	1.1	34.8
X	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art. të tyre	17.8	20.1	29.4	1.7	1.5	2.0	46.5
XI	Tekstilët dhe artikujt tekstilë	119.4	136.8	163.0	11.2	10.3	11.0	19.1
XII	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat, lule artificiale	35.6	47.3	55.6	3.3	3.6	3.7	17.5
XIII	Art. prej guri, allçie, çimentoje, qeramike, qelq	41.9	49.2	57.9	3.9	3.7	3.9	17.5
XIV	Perlat; gurë e metalet të çmuar; bizhuteri; monella	2.7	0.4	0.4	0.3	0.0	0.0	-10.8
XV	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	84.0	117.7	133.7	7.9	8.9	9.0	13.6
XVI	Makineri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	148.1	244.1	240.4	13.9	18.4	16.2	-1.5
XVII	Mjete transporti, avionë, anije, pajisje shoqëruese transp.	79.5	70.0	80.9	7.5	5.3	5.4	15.6
XVIII	Instrumente e aparate optike, orë; instrum. muzikore	16.5	19.3	14.3	1.5	1.5	1.0	-25.7
XIX	Armët e municione; pjesët e plotsuesit e tyre	0.7	0.6	0.7	0.1	0.0	0.0	14.0
XX	Artikujt të ndryshëm të prodhuar	24.5	30.4	36.5	2.3	2.3	2.5	20.0
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikat	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0	...
	TOTALI	1,065.6	1,324.8	1,487.3	100.0	100.0	100.0	12.3

Peshën më të ndjeshme në strukturën e importeve shqiptare, edhe këtë vit, vazhdojnë ta ruajnë importet e makinerive dhe pajisjeve, me rreth 16 për qind të totalit, duke kontribuar në rritjen e aktiveve fikse dhe në rinovimin e bazës teknologjike të ekonomisë. Importet në makineri e pajisje i përkasin kryesisht teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë këtu shpërndarjen e antenave të mediave elektronike si dhe të telefonisë celulare si dhe rehabilitimin e rrjetit të amortizuar elektrik në vend.

Importi në makineri e pajisje është karakterizuar nga tendenca rritëse veçanërisht gjatë viteve të fundit, edhe pse, këtë vit vlerësohet lehtë në rënie (1 për qind) kundrejt vitit 2001, vit në të cilin këto importe u stimuluan, kryesisht, nga hyrja në treg e operatorëve të telefonisë celulare AMC dhe Panafon Vodafon.

Importet në produkte minerale përfaqësuan në masën 13 për qind shpenzimet totale në importin e mallrave realizuar gjatë këtij viti. Krahasuar me vitin 2001 ato vlerësohen 4 për qind më të larta. Kriza energjitike në vend ka rritur importet në energji elektrike si dhe ka mbajtur në nivele të larta importet në karburante për t'u përdorur si zëvendësues. Gjatë vitit janë importuar rreth 395 milionë kwh energji elektrike më shumë se në vitin e kaluar, duke çuar në rritje të shpenzimeve të



importit në energji elektrike me rreth 17 për qind. Importi i karburantëve vlerësohet në rënie (9 për qind) kundrejt një viti më parë, megjithatë, ruan nivele të konsiderueshëm krahasuar me vitet e mëparshme.

Rritje të ndjeshme kanë pësuar, gjithashtu, importet në tekstile dhe veshje të këmbëve. Importet në këta grupmallra përfaqësuan rreth 15 për qind të totalit të importit dhe vlerësohen 19 për qind më të larta në krahasim me vitin 2001. Lulahshmëria e këtyre importeve reflekton zhvillimet në sektorin e rieksperteve. Përgjatë vitit periudhat me flukset më të larta në importet e kësaj kategorie mbeten tremujori i dytë dhe i katërt.

Zhvillimet në sektorin e ndërtimeve në vend janë reflektuar në importe të larta në çimento, produkte qeramike dhe materiale të tjera për ndërtim. Gjatë vitit 2002, ky sektor ka shënuar një rritje prej rreth 9.1 për qind krahasuar me një vit më parë. Në tremujorin e katërt, rritjen kryesore të shpenzimeve direkte për ndërtim e kanë dhënë shpenzimet për materiale ndërtimi dhe makineri, të cilat janë reflektuar në rritje të vëllimit të importeve të makinerive e pajisjeve dhe lëndëve të para për ndërtim.


Rritja në **eksporte** erdhi, në një masë të konsiderueshme, si rezultat i rritjes 10 për qind të rieksperteve (eksporte me material porositesi), të cilët vazhdojnë të mbajnë pjesën kryesore të eksporteve tona. Gjithashtu në rritje, edhe pse jo i dukshëm në volum, shfaqet eksporti nga prodhimi i brendshëm (me 4 për qind). Kategoritë kryesore të mallrave të përpunuar në Shqipëri, edhe këtë vit, përfaqësohen nga artikujt tekstilë dhe veshje të kokës dhe këmbës. Struktura e eksporteve vuan nga shkalla e ulët e diversifikimit. Kështu, gjatë vitit 2002 rreth 67 për qind e volumit të eksporteve përbëhet nga eksportet në grupmallrat e lartpërmendur.

**Tabelë 4. Eksporti sipas 21 grupmallrave (në milionë usd).**

HS	PËRSHKRIMI	Volumi (në milionë dollarë)			Pesha (në %)			Ndryshimi (në %) 2002/2001
		2000	2001	2002	2000	2001	2002	
I	Kafshët e gjalla; Produktet me origjinë kafshore	1.8	2.3	2.1	0.7	0.7	0.7	-5.7
II	Produktet vegjetale	12.1	11.4	13.1	4.7	3.8	4.0	14.6
III	Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	180.9
IV	Ushqime të përgatitura, pije alkoolike e uthull, duhan	13.7	14.1	7.3	5.4	4.6	2.2	-48.5
V	Produkte minerale	7.4	5.9	9.1	2.9	1.9	2.8	55.5
VI	Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	1.4	3.0	1.6	0.6	1.0	0.5	-45.8
VII	Plastikat; gomat dhe artikujt e tyre	0.9	1.0	0.7	0.3	0.3	0.2	-31.2
VIII	Lëkurat e papërpunuara e të përpunuara, artikujt e tyre	8.3	10.9	14.8	3.2	3.6	4.5	35.9
IX	Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	7.3	8.7	8.6	2.9	2.9	2.6	-1.6
X	Brumi i drurit, mbetjet e letrës, letra, kartoni art. të tyre	2.6	1.7	2.9	1.0	0.6	0.9	70.1
XI	Tekstilët dhe artikujt tekstilë	108.7	113.8	124.4	42.5	37.4	37.7	9.3
XII	Veshjet e këmbëve, të kokës, çadrat, lule artificiale	69.0	87.1	95.3	27.0	28.6	28.9	9.4
XIII	Art. prej guri, allçie, çimentoje, qeramike, qelq	0.7	1.8	1.9	0.3	0.6	0.6	3.7
XIV	Perlat; gurë e metalet të çmuar; bizhuteri; monella	0.5	4.5	0.4	0.2	1.5	0.1	-91.9
XV	Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	21.5	24.4	30.8	8.4	8.0	9.3	26.5
XVI	Makineri e pajisje mekanike, elektrike, pjesët e tyre	4.4	7.1	8.4	1.7	2.3	2.6	19.4
XVII	Mjete transporti, avionë, anije, pajisje shoqëruese transp.	0.2	0.9	0.9	0.1	0.3	0.3	-8.5
XVIII	Instrumente e aparate optike, orë; instrum. muzikore	0.5	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1	47.2
XIX	Armët e municione; pjesët e plotsuesit e tyre	1.7	0.4	0.7	0.7	0.1	0.2	49.4
XX	Artikujt të ndryshëm të prodhuar	7.1	5.1	6.8	2.8	1.7	2.1	33.3
XXI	Veprat e artit, copat e mbledhura nga antikant	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	-74.1
	TOTALI	255.9	304.6	330.2	100.0	100.0	100.0	8.4

Eksporti i brendshëm shqiptar konsiderohet i pazhvilluar, përbërë nga produkte bujqësore (bimë medicinale, duhan), nga metale (ferrokrom dhe alumin), nga lëkurë, nga lëndë drusore dhe nga produkte minerale (karburante). Niveli i përfaqësimit të eksportit të brendshëm, në totalin e eksportit, në vitin 2002 vlerësohet në 26 për qind dhe përgjatë viteve të fundit ka shfaqur tendencë rënëse (grafik 5).

**Grafik 5. Ecuria e eksportit të brendshëm (në mln usd).**



Një ndër arsyt kryesore të kësaj tendence është shkalla e ulët e konkurrencialitetit e shoqëruar me aftësnë e kufizuar të prodhimit vendas për të përfituar nga tregjet e vendeve të rajonit, fragmentimin e ekonomisë shqiptare si dhe nivelin e ulët të integritimit ekonomik të brendshëm

### 2.1.3 Partnerët tregtarë


Aktiviteti tregtar i Shqipërisë me botën mbetet me orientim kryesor drejt vendeve të Bashkimit Evropian, me partnerë tregtarë brenda këtij grupi, Italinë, Greqinë dhe Gjermaninë. Ndërkohë që, tregtia në rajon<sup>2</sup> vlerësohet të qëndrojë në nivele të ulta. Kështu, importet nga vendet e Bashkimit Evropian zunë 75 për qind të totalit, ndërsa importet nga vendet e rajonit vetëm 16 për qind të importeve. Më e fuqishme është varësia në eksporte me vendet e Bashkimit Evropian. Kjo, për faktin se investitorët kryesorë në industrinë e përpunimit aktiv në vend mbeten Italia dhe Greqia. Mëse 92 për qind e eksporteve pati për destinacion vendet e Bashkimit Evropian dhe vetëm 4.8 për qind vendet e rajonit.

**Tabelë 5: Struktura e import-eksporteve sipas partnerëve.**

	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
	<i>import (%)</i>						
Bashkimi Evropian	76	83	83	80	77	78	75
Vendet e rajonit	16	12	10	14	15	15	16
Të tjera	8	5	7	6	9	8	9
	<i>eksport (%)</i>						
Bashkimi Evropian	86	88	93	94	93	92	92
Vendet e rajonit	9	9	4	4	5	6	4
Të tjera	5	3	3	2	2	3	4

<sup>2</sup> Në këtë grupim përfshihen Bullgaria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Jugosllavia (përfshi Mali i Zi dhe Kosova), Maqedonia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia.


**Grafik 6. Tendanca e shkëmbimeve tregtare (në volum eksport + import) të Shqipërisë me partnerët kryesorë. (Indeks: 1996=100).**



Periudha të cilën po analizojmë nuk solli ndryshime përsa i përket gjeografisë së tregtisë së jashtme. Partnerët kryesorë të Shqipërisë në tregtinë e jashtme mbeten Italia, Greqia, Turqia dhe Gjermania. Tregtia me këto vende ka arritur në rritje përgjatë vitit 2002.

Grafiku i mëposhtëm jep një pamje të krahasueshme të ecurisë së tregtisë sipas grupmallrave, për vitet 2002 dhe 2001, me dy partnerët kryesorë të Shqipërisë në tregti: Italia, e cila përfaqëson destinacionin e 72 për qind të eksporteve dhe tregun e 35 për qind të importeve shqiptare; dhe Greqia me përkatësisht 13 dhe 26 për qind.

**Grafik 7. Tregtia në mallra me partnerët kryesorë (në milionë dollarë).**



Gjatë vitit 2002 vendi është angazhuar në nënshkrimin e një sërë marrëveshjesh të Tregtisë së Lirë mes vendeve të Evropës Juglindore (shih Box 1), të cilat priten të sjellin një rritje të shkëmbimeve tregtare në rajon.

Në stadin aktual, shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me vendet e përfshira në procesin e krijimit të zonës tregtare të lirë, janë mjaft të kufizuara. Kështu, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes me Maqedoninë, më 1 gusht të vitit 2002, tregtarët shqiptarë dhe ata maqedonas kryejnë shkëmbime tregtare në bazë të kushteve të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë Shqipëri-Maqedoni. Megjithatë, lehtësitë doganore për eksportet e prodhimeve shqiptare, të përcaktuara mbi bazën e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, ende nuk po shfrytëzohen nga prodhuesit vendas. Prodhuesit dhe tregtarët shqiptarë kanë eksportuar artikuj në nivele të ulta. Kjo, për shkak të nivelit të ulët të marketingut dhe të mungesës së kapaciteteve për t'iu përshtatur standardeve evropiane. Pritet të fillojë aplikimi i marrëveshjes me Kroacinë. Megjithatë, mund të thuhet se duke marrë parasysh përqindjen e ulët të deficitit tregtar ndaj këtyre vendeve, në raport me deficitin

tregtar total (vetëm 9 për qind për vitin 2002) dhe faktin që niveli i konkurrencialiteti të ekonomive të vendeve të rajonit nuk ndryshon shume nga ai vendas, këto marrëveshje nuk pritet të japin një kontribut të dukshëm në një periudhë afatmesme.

**Box 1. Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë të Shqipërisë në Rajon**  
*- gjatë vitit 2002 Shqipëria nënshkroi 6 Marrëveshje për Tregtinë e Lirë*

Shqipëria, si dhe vendet e tjera të Evropës Juglindore, me nënshkrimin në Bruksel të Memorandumit të Mirëkuptimit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë, në 27 qershor 2001, institucionalizoi angazhimin për t'u bërë pjesë e zonës së tregtisë së lirë në rajon.

Objektivi kryesor i marrëveshjes është krijimi nga palët, në mënyrë graduale, i një zone të tregtisë së lirë gjatë një periudhe tranzitore me kohëzgjatje maksimale prej 6 vjetësh. Kjo do të thotë që pas vitit 2008, në shkëmbimin e mallrave midis vendeve pjesëmarrëse nuk do të aplikohen tarifa doganore. Objektivat specifike të marrëveshjes përmbajnë:

(i) zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet palëve dhe rritja e standardit të jetesës së popujve, (ii) eliminimi gradual i kufizimeve në tregtinë e mallrave, (iii) vendosja e kushteve të barabarta konkurruese për tregtinë e mallrave, (iv) kontribuimi në heqjen e barrierave ndaj tregtisë, në zhvillimin e harmonizuar dhe në zgjerimin e tregtisë botërore, (v) krijimi i kushteve për nxitjen e mëtejshme të investimeve, veçanërisht për zhvillimin e investimeve të përbashkëta në këto vende/në rajon, (vi) nxitja e tregtisë dhe e bashkëpunimit midis palëve me vendet e treta.

Krijimi i zonës së lirë tregtare mes vendeve të rajonit prek kryesisht sektorin industrial, ndërsa sektorët e bujqësisë dhe të industrisë së mallrave ushqimorë, në shumë raste parashikojnë hapje të pjesshme e graduale ose ruajtje të regjimit aktual tregtar. Për këtë arsye, efektet e pritshme negative mbi konkurrencialitetin e sektorit bujqësor mund të konsiderohen në nivele të neglizhueshme.

Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve do të intensifikojë shkëmbimet tregtare të Shqipërisë në rajon, duke sjellë, gjithashtu, krijimin e mundësive të reja të biznesit, nxitjen e investimeve, zbutjen e papunësisë si dhe transferimin e teknologjisë së re. Fitimi ekonomik nga rritja e tregtisë do të kompensojë humbjen e mundshme të të ardhurave fiskale nga doganat. Nga ana tjetër, zona e pritshme e tregtisë së lirë përbën një treg prej rreth 60 milionë konsumatorësh. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nisur nga fakti që këto vende janë ekonomi të vogla me treg të brendshëm të përmasave të kufizuara. Integrimi ekonomik do ta bëjë rajonin më tërheqës ndaj investitorëve të huaj si dhe ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare.

Shqipëria ka tashmë Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me:

- Maqedoninë, aplikuar nga 1 gushti i vitit 2002;
- Kroacinë, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë;

është në stadin e nënshkrimit teknik të marrëveshjes me:

- Bosnjë-Hercegovinën;
- Serbia dhe Mali i ZI;
- Rumaninë;


si dhe në raund negociatash me:

- Bullgarinë;
- Moldavinë.

## **2.2 SHËRBIMET**

Tregtia e shërbimeve, gjatë vitit 2002, regjistroi një volum transaksionesh prej 1.17 milionë dollarë. Në strukturën e shërbimeve aktiviteti i turizmit (kategoria e udhëtimit) zë peshën më të madhe me rreth 72.5 për qind dhe pasohet nga shërbimet e transportit me 12 për qind.

**Grafik 8. Bilanci i shërbimeve (në mln usd)**



Eksporti dhe importi i shërbimeve vlerësohen në rritje kundrejt vitit të kaluar respektivisht me 10 dhe 33 për qind. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga të ardhurat dhe shpenzimet e perftuara nga aktiviteti i turizmit. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë<sup>3</sup> ky aktivitet ka gjeneruar të ardhura 486.9 milionë dollarë, shifër kjo rreth 47 për qind më e lartë se eksporti i mallrave dhe shpenzime rreth 366 milionë dollarë ose rreth 60 për qind të totalit të dërgesave nga emigrantët. Vlen të përmendet efekti i sezonalitetit të këtij aktiviteti kryesisht në tremujorin e trete dhe të katert. Mund të thuhet se gjatë vitit 2002 ka pasur një rritje të madhe në numrin e udhëtarëve që kanë vizituar Shqipërinë me rreth 20 për qind kundrejt vitit të kaluar dhe ky mund të konsiderohet si një tregues i mjaftueshëm që



dëshmon për rritjen e aktivitetit në këto shërbime. Gjithashtu, vihet re një rritje e madhe edhe në shpenzimet ditore të shqiptarëve që udhëtojnë jashtë shtetit me 39 për qind, faktor ky që ka ndikuar në rritjen prej 42 për qind të shpenzimeve të turizmit.

Është tashmë e ditur se shërbimet e transportit dhe ato të sigurimit ndjekin zhvillimet në aktivitetin tregtar të mallrave. Rritja e vëllimit të importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Në fund të vitit, ato regjistruan deficite respektivisht prej 18.4 dhe 12.3 për qind më të larta se ato të vitit 2001.

### **2.3 TË ARDHURAT**

Bilanci pozitiv i të ardhurave, në fund të vitit, vlerësohet rreth 126 milionë dollarë. Ky suficit i dedikohet të ardhurave nga puna e punëtorëve sezonalë dhe atyre kufitarë, të ardhurave nga investimet në formën e interesave, të akumuluar nga investimi i rezervave valutore të sistemit bankar dhe investimeve të portofolit. Ky suficit vlerësohet në rënie kundrejt vitit 2001 (15 për qind), megjithë rritjen e të ardhurave nga investimet e portofolit (20 milionë dollarë). Rënia e këtij suficiti ka të bëjë me rënien e të ardhurave nga investimet në formën e depozitave të sistemit bankar jashtë, si dhe me rritjen e të ardhurave dalëse në formën e shlyerjes së borxhit të jashtëm (pagesave të interesave të maturuar) të cilat regjistruan shifrën 18.5 milionë dollarë.

### **2.4 TRANSFERTAT**


Transfertat korente, gjatë vitit 2002, regjistruan një suficit prej 613 milionë dollarë dhe vlerësohen 7.4 për qind më të larta se një vit më parë. Kjo rritje erdhi si pasojë e rritjes së transfertave hyrëse, kryesisht nga të ardhurat nga emigrantët të cilët kanë regjistruar shifrën 631.5 milionë dollarë me një rritje prej 3 për qind nga viti i kaluar. Rritja e suficitit, i detyrohet edhe rënies së transfertave të tjera dalëse, kryesisht atyre të sektorit privat, të cilat vlerësohen 21.5 për qind më të

---

<sup>3</sup> Sipas rezultateve të nxjerra nga vrojtimet e kryera çdo tremujor nga Banka e Shqipërisë.

ulëta se ato të një viti më parë.

**Grafik 9. Struktura e transfertave .**



Sipas statistikave, vlerësohet që rreth 50 për qind e këtyre flukseve hyrës në mjete valutore është kanalizuar nëpërmjet sistemin bankar, pjesa tjetër ka hyrë në formën *cash* duke nxitur kryesisht rritjen impoiteve të mallrave të konsumit. Këto flukse kanë financuar me rreth 55 për qind deficitin tregtar ose 5 pikë përqindjeje më pak se në vitin e kaluar (këto financonin 60 për qind të deficitit tregtar).

Ndërkohë, transfertat shtetërore regjistrojnë rreth 40 milionë dollarë, dhe përfaqësohen nga ato në asistencë teknike dhe ato në formë ndihmash në mallra.


### **3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE**

Viti 2002 regjistroi një fluks neto kapitalesh prej 327 milionë dollarësh. Transfertat e kapitalit regjistrojnë rreth 121 milionë dollarë dhe llogaria financiare paraqitet me një bilanc pozitiv prej 206 milionësh, duke u vlerësuar rreth 1.8 here më e lartë kundrejt vitit 2001.

### 3.1 DETYRIMET FINANCIARE

Shqipëria i rriti detyrimet e saj financiare me rreth 277 milionë dollarë. Rritja e këtyre detyrimeve është realizuar kryesisht nga huamarrja, nga investimet e huaja direkte si dhe nga investime të tjera në formën e depozitave të bankave dhe të institucioneve financiare jorezidente në sistemin tonë bankar.

**Grafik 10. Flukset financiare (në mln usd).**



Lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, kanë shtuar borxhin e jashtëm të Shqipërisë me 150 milionë dollarë. Këto disbursime përfaqësojnë me 97 për qind detyrimet e qeverisë në formën e kredive shtetërore dhe atyre të garantuara, kryesisht nga kreditë e Bankës Botërore nëpërmjet Agjencisë së Zhvillimit (IDA). Pjesa tjetër përfaqëson rritjen e detyrimeve të sektorit privat. Shlyerja e detyrimit të borxhit të jashtëm regjistroi rreth 41 milionë dollarë, rreth 1.8 herë më e lartë se viti paraardhës.

Kapitaleve të investuara në formën e huamarrjes u janë shtuar dhe flukset e kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte. Këto flukse vlerësohen rreth 135 milionë dollarë amerikanë dhe vijnë kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian (rreth 87 për qind) dhe rreth 6 për qind nga vendet e rajonit. Këto investime janë kryesisht të përqëndruara në industrinë e përpunimit të mallrave për rieksperte.

Krahasuar me vitin 2001 vihet re një rënie e këtyre investimeve prej 35 për qind. Kjo rënie vjen pasi këtë vit nuk u kryen privatizimet e ndërmarrjeve shtetërore të parashikuara.

Detyrimet në formën e depozitave të jorezidentëve në sistemin tonë bankar janë rritur me 8.3 milionë dollarë. Ndryshim të dukshëm në këtë vit ka pasur në përbërjen e depozitave. Këto depozita janë kryesisht në euro dhe pasohen nga ato në dollarë duke zënë respektivisht rreth 75 dhe 21 për qind të totalit kundrejt 58 dhe 32 për qind që ato zinin në vitin 2001.

### **3.2 MJETET FINANCIARE**

Aktivët valutore të Shqipërisë kundrejt pjesës tjetër të botës, gjatë vitit 2002, janë rritur me 59 milionë dollarë amerikanë dhe përfaqësojnë vetëm 27 për qind të rritjes së vitit 2001. Kjo ka ardhur si pasojë e rënies së mjeteve valutore në forme depozitash në bankat e huaja. Vlen të përmendet këtu, rënia e në mjetet valutore të zotëruara nga rezidentët shqiptarë në sistemin tonë bankar në periudhën mars-prill 2002, shkaktuar kjo si pasojë e rënies së besimit të tyre në sistemin bankar, duke i detyruar bankat të tërhiqnin depozitat e tyre jashtë për të përmbushur nevojat e tyre me likuiditet.


Kjo fenomen zgjati vetëm në gjysmën e parë të vitit, pasi në gjashtëmuorin e dytë rikthimi i depozitave të publikut në sistemin tonë bankar ka bërë në këtë periudhë që këto banka të rrisin depozitat e tyre jashtë. Kështu, në fund të vitit, rritja e këtyre depozitave u vlerësua me 26.4 milionë dollarë. Këto depozita janë kryesisht në dollarë dhe në euro, respektivisht me 54 dhe 45 për qind.

Mjetet financiare në formën e *investimeve të portofolit* arritën shumën prej rreth 119 milionë dollarë duke rritur kështu mjetet tona financiare me 36.8 milionë dollarë.

## **4. REZERVAT**

Flukset hyrëse në mjete valutore, në formën e kapitaleve financiare (kryesisht disbursimet e kredive të huaja dhe përdorimi i kredive të FMN-së) u reflektuan në rritjen e rezervave valutore të autoritetit monetar me rreth 28.6 milionë dollarë, për vitin 2002.

**Grafik 11. Rezervat e Autoritetit Monetar.**



Kjo rritje është regjistruar kryesisht në mjetet valutore, ndërkohë që ato në SDR vlerësohen në rënie. Niveli i rezervave valutore, në fund të vitit, u vlerësua 838.9 milionë dollarë, i mjaftueshëm për të përballuar 4.8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh, kundrejt 4.9 që ishte parashikuar në programin monetar.